



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 14 Prot

Tiranë, më 06/01 2015

REKOMANDIM

Nr. 02 ,datë 06/01 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

KONSTATOVA:

Në zbatim të urdhrin nr. 205, datë 21.11.2014 është ushtruar kontroll administrativ pranë kontrolluesit "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë". Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, që zhvillon aktivitetin e tij, për garantimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve, për mbrojtje sociale, arsim profesional, punësim të sigurtë, sigurim shoqëror etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rolin e kontrolluesit gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për shtetas shqiptar të cilët marrin shërbimet dhe kryejnë procedura pranë këtij kontrolluesi, si dhe për kategorinë punonjës.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi relacionin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre. Në faqen zyrtare në internet <http://www.sociale.gov.al>, nuk është vendosur rubrika "politikat e privatësisë" me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe përfshirjen në këtë rubrikë të kushteve, kriterëve që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale, sipas kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqeve zyrtare në internet duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në rolin e kontrolluesit të të dhënave personale, është në fazën e hartimit të kontratave të shërbimit me palë të treta për funksionimin e sistemeve online dhe të brendshme që përdor, si dhe në kuadër të kryerjes së detyrave të tij ligjore, realizon “marrëveshje bashkëpunimi” me shtete të tjera. Në këto kontrata dhe marrëveshje duhet të përfshihen rregulla mbi përdorimin dhe sigurinë e të dhënave personale sipas kërkesave të nenit 20 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 19 datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Përcaktimi në kontrata dhe marrëveshje i detyrimeve për përdorimin e ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale është detyrë parësore e kontrolluesit. Ligjshmëria, siguria dhe konfidencialiteti për përdorimin e të dhënave personale duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana e kontrolluesit.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nuk ka plotësuar saktë disa nga rubrikat e “Formularit të Njoftimit” (1.1, 1.2, 3.1, 4.1, 5.1, 7.1, 8.1) sipas parashikimeve të nenit 21 “Përgjegjësia për të njoftuar” të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Formulari i njoftimit duhet të plotësohet me saktësi dhe vëmendje maksimale nga kontrolluesi, deklarimi i masave për sigurinë e të dhënave personale, i personit të kontaktit (personi i ngarkuar për të dhënat personale), si dhe regjistrimi i tyre pranë Autoritetit të Komisionerit shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi.

Në rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” nuk janë përfshirë rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”:

#### **REKOMANDOJ:**

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në faqen tuaj në internet <http://www.sociale.gov.al>, të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opinionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të IDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

2. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 19 datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e

*marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, në hartimin e kontratave të shërbimit me palë të treta si dhe në “marrëveshje bashkëpunimi” me shtete të tjera, të përcaktohen kushte dhe kritere të cilat garantojnë një përpunim të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.*

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të IDP [www.idp.al](http://www.idp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

